



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 64

Prishtinë, më 23.01.2017 në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Agim Çeku, Mufera Shinik, Kimete Bytyqi, Fisnik Ismaili, Ali Berisha, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Munguan: Jasmina Zhivković, Milka Vuletiq, Sasha Milosavljeviq dhe Slavko Simiq.

Pjesëmarrës të tjerë : përfaqësues nga OSBE-ja, Sanije Berisha; përfaqësuese nga KDI-ja, Agnesa Haxhiu; konsultant i Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtpriria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Agim Çeku**, nënkryetar i Komisionit..

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura me datë: 22.12.2016 dhe 23.12. 2016;**
3. **Miratimi i Raportit vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2016;**
4. **Hartimi i Planit dhe Programit të punës së Komisionit për vitin 2017;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Agim Çeku- nënkryetar i parë, konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e mbajtura të Komisionit me datë: 22.12.2016 dhe 23.12.2016;**

Nënkryetari, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjeve të mbajtura më 22.12.2016 dhe 23.12.2016, pa vërejtje.

3. Miratimi i Raportit vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2016;

Nënkryetari, tha se e ka lexuar me përkushtim raportin e punës për vitin 2016 dhe konsideron se janë përfshirë të gjitha aktivitetet dhe detyrimet e komisionit në kuadër të fushëveprimit të tij të punës dhe përgjegjësi nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve, siq janë: shqyrtimi i raporteve me amandamente të Komisioneve funksionale për Projektligje, hartimi i raporteve me rekomandime për Kuvend, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, realizimi i vizitave në terren dhe rajonë. Kërkoj që anëtarët e komisionit të ofrojnë opinionet e tyre eventuale dhe i njejtë të hudhet në votim. .

Veton Berisha, pajtohet se raporti i punës është hartuar mirë. Mendoj se ky vit ka qenë i dështuar për arsye të bojkotit të kolegëve, dhe kjo situatë ka ndikuar në mos zhvillohen aktivitetet e shumë proceseve. Nuk kanë munguar kontakte individuale me përfaqësues të institucioneve dhe me kryetar të komunave ku kam referuar për problematikat me të cilat ballafaqohet komuniteti jonë e një ndër brengat kryesore është gjendja e jetesës së mjerueshme. Kërkoj që interesat e komuniteteve të jenë kolektive e të mos anohet veçmas vetëm për një komunitet. Në kuadër të arsyeve të lartëcekura, ai apstenon votimin e raportit të punës për vitin 2016.

Danush Ademi, në vitin e kaluar është punuar me përkushtim për përmbushjen e aktiviteteve tona. U shpreh se me kërkesën e tij dhe të kolegëve Qerimi Bajrami dhe Mufera Sinik kemi inicuar çështjen e arsimit në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe janë arritur rezultate pozitive. Është për tu përshëndetur MASHT-i i cili ka përmbushur obligimin ligjor me rastin e nxjerrjes së udhëzimit administrativ ku kanë përfituar shumë studentë të komuniteteve joshumicë .

Mufera Sinik, pajtohet se në draft raportin e punës janë përfshirë të gjitha aktivitetet të cilat i ka zhvilluar komisioni. Kishte një vërejtje, se deri më sot nuk janë marrë listat me emra të punonjësve në shërbimin publik, mirëpo këtë vit shprehet se do të kemi informacione zyrtare për përfaqësimin e drejtë të komuniteteve.

Qerim Bajrami, ishte i mendimit se raporti i punës është i hartuar mirë. Kishte një propozim konkret, në pikën C. 6 . që lidhet me temën e përfaqësimit të komuniteteve joshumicë në sektorin e shërbimeve mediale në pajtim me Ligjin për RTK-në, të shtohet pjesëmarrja e drejtorit të RTK-2 Slavoljub Kuziq.

Nuk pajtohet me qëndrimin e Vetonit se viti paraprak ka qenë i pa sukseshëm nga se komisioni është qasur në mënyrë serioze dhe janë arritur rezultate të mira. Konsideron se puna është zhvilluar në rrethana të vështira pasi është bojkotuar nga anëtarët e listës SL dhe në shumicën e rasteve ka munguar quorumi. Me këtë rast, shfrytëzoi mundësinë të kërkojë nga kryesuesi i komisionit që të bëhet ftesë për pjesëmarrje anëtarëve serb, me qëllim që komisioni të vendos me shumicën e votave dhe rezultate më efektive. Si propozim tjetër, ishte që komisioni të zgjerohet edhe me një anëtarë tjerë të komunitetit që ai i përket, me arsye që të ngriten çështjet e rëndësishme të veçantë për këtë komunitet.

Nënkryetari, iu përgjigj parafolësit se përbërja e komisionit është e përcaktuar me Kushtetutë andaj nuk jemi kompetent të bëhen ndryshime të tilla. Sa i përket përfaqësuesve të LS, ata janë përgjegjës për pjesëmarrjen e tyre në Kuvend.

Ali Berisha, theksi se komisioni ka realizuar aktivitetet e përcaktuara ligjore. Veçoi se Ligjet e miratuara në Kuvend janë më të avansuara në rajon për nga aspekti i adresimit të drejtë në interes të komuniteteve dhe integrimi i tyre në shoqërinë Kosovare.

Ishte i mendimit se komisioni duhet të monitorojë më shumë komuna me qëllim të identifikohen informatat e sakta lidhur me zbatueshmërinë e ligjeve.

Sa i përket vizitave rajonale, konsideron se nuk janë të nevojshme marrja e përvojave nga vendet e ndryshme nga se janë të avansuara në masë të duhur interesat e komuniteteve në Kosovë.

Kimete Bytyqi, pajtohet se komisioni duhet të vizitojë Kuvendet komunale që të shohim për së afërmi se në çfarë mase zbatohen Ligjet, bazuar në respektimin e të drejtave të komuniteteve. Nuk e arsyeton mendimin e Aliut që komisioni nuk ka nevojë të bëjë vizita rajonale, përkundrazi ajo mendon se këto vizita janë të nevojshme sepse shërbejnë të marrim përvoja të reja, si zhvillohet jetesa e komuniteteve në rajon.

Qerim Bajrami, nuk pajtohet me diskutimet se të drejtat e komuniteteve joshumicë mbrohen me ligje, kur dihet se realiteti është ndryshe, si për shembull në Komunën e Pejës, në shkolla fillore mungon abetarja në gjuhën boshnjake gjithashtu edhe librat në shkolla të mesme. Andaj kërkoi që me anë të komisioni të inicohet çështja e ngritjes së kapacitetit për nxënësit e komunitetit në fjalë.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me shtatë vota Për, një votë Apstenim, nxorri këtë:

Përfundim

Në këtë mbledhje, Komisioni miratoi raportin e punës për vitin 2016

4. Hartimi i Planit dhe Programit të punës së Komisionit për vitin 2017;

Nënkryetari, tha se në bazë të Përfundimit të Kryesisë, ngarkohen komisionet parlamentar që mbi bazën e Programit Legjislativë të Qeverisë të Republikës së Kosovës për vitin 2017, të hartojë planin e punës periodike të komisionit për vitin 2017, deri më 27 janar 2017.

Në bazë të Draft Planit të punës për vitin 2017, janë përmbledhur aktivitetet e Komisionit në aspektin e mbrojtjes së të Drejtave dhe Interesave të Komuniteteve.

Janë caktuar detyrat lidhur me vlerësimin e amandamenteve të propozuara nga komisionet funksionale, hartimi i rekomandimeve për Kuvend, monitorimi i zbatimit të ligjeve, ndërsa kanë mbetur të plotësohen disa vizitat në terren dhe planifikimi i aktiviteteve tjera.

I njoftoi anëtarët e komisionit se në bazë të programit legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017, me datë 31.08.2017 ngarkohet Komisioni për të Drejtat dhe interesat e Komuniteteve dhe Kthim të shqyrtojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Komisioni do të formon grupin punues për shqyrtimin e këtij Ligji.

Si aktivitet i rëndësishëm i komisionit është mbikqyrja e monitorimit të Ligji për Vetëqeverisje Lokale si dhe mbikqyrja e Ligjit për vetëqeverisjen lokale (nga aspekti i kontrollit buxhetor).

Në këtë vit, Komisioni do të realizojë vizitë regjionale në Republikën e Malit të Zi, në bashkëpunim dhe mbështetje të misionit të OSBE-së.

Nënkryetari, hapi depat, që anëtarët e komisionit të ofrojnë propozimet e tyre.

Veton Berisha, Në bazë të draft- planit të punës për vitin 2017, shihet se programi legjislativ i Qeverisë e ka paraparë të shqyrtohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës dhe monitorimi i dy ligjeve.

Si propozim i tij ishte që Komisioni të bëjë monitorimin e nenit 11, të Ligjit për Buxhetin e vitit 2017, i cili nënka të bëjë me planin strategjik të ndarjes buxhetore për komunitete.

Mundësitë ligjore janë të mira por dallojnë ndërmarrjet e veprimeve në praktikë për komunitetin joshumicë. Për ballafaqimin e problematikës së kësaj natyre, propozoi që këtë vit komisioni të realizojë më shumë vizita në terren. Si propozim i tij ishte që të vizitohet fshati Dubrav në Ferizaj, lagjja Prajkocë në Gjakovë, fshati Medvec në Lipjan, Istogu, Leposaviqi dhe Mamusha.

Me realizimin e këtyre vizitave, çësja do të jetë më të afër me qytetarët dhe në fund të vitit do të dalim me një raport real.

Qerim Bajrami, mendon se draft -plani i punës është i hartuar mirë. Sa i përket çështjes së vizitave në terren pajtohet me propozimet e parafolësve dhe shtoi ë vizitohet Vitomirica në Komunën e Pejës, Restelica në komunën e Dragashit

Si temë të veçant, ngriti çështjen e mos ndarjes adekuate buxhetore për komunitetin boshnjak dhe shfrytëzoi rastin të kërkojë që sa më par ti bëhet ftesë drejtorit të Zyrës për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit, z.Ivan Tomiq për të raportuar lidhur me implementimin e strategjive të Qeverisë dhe ndarjen buxhetore të përcaktuara për komunitetet.

Danush Ademi, ishte i mendimit se për realizimin e vizitave në terren t'ju bëhet ftesë edhe ministave të linjes me qëllim që të shohin për së afërmi gjendjen reale të komunitetit pakicë . Propozoi të vizitohet fshati Babush në Komunën e Ferizajit .

Nënkryetari, me theks të veçant tha se në aktivitetet e Planit të punës, duhet të jenë të identifikuar vizitat e Kuvendeve Komunale, dhe në periudha të caktuara komisioni do të përcaktojë detyrat, si zhvillohet jetesa e tyre , pengesat me të cilat ata ballafaqohen dhe sa janë të inkuadruar në shoqëri.

Mufera Sinik- theskoi se plani i punës për vitin 2016, ka qen i thuktë, mirëpo nuk realizuar të gjitha çështjet e parapara për shkak të situatës të krijuar institucionale. Mendon se komisioni duhet të jetë më azhur në përmbushjen e detyrave sipas Planit të punës për vitin 2017.

Pajtohet me propozimin e parafolësve lidhur me procedurat e monitorimit të ligjeve, realizimin e vizitave në terren dhe vizitës rajonale.

Si propozim i saj konkret ishte që të vizitohet shkolla në Mamushë, për të par si zhvillohet mësimi në gjuhën turke.

Nënkryetari, konstatoi se Komisioni do të rishqyrtoj Planin e Punës në periudhat tremujore duke identifikuar objektivat e Programit legjislativ të Qeverisë për vitin 2017.

Në bazë të diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

Komisioni miratoi Planin e Punës për vitin 2017, me arsye që të bëhet rishqyrtimi i planit dhe i rezultateve të punës për tre mujorin e parë, gjashtëmujorin e dytë dhe ndryshimet eventuale të planit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetar i Komisionit

Agim Çeku